

ISSN 1127-8579

Pubblicato dal 08/04/2010

All'indirizzo <http://www.diritto.it/docs/29271-p-rcaktimi-formal-i-vepr-s-penale>

Autori: Arben Isaku, Isaku Lulieta

Përcaktimi formal i veprës penale

PËRCAKTIMI FORMAL I VEPRËS PENALE

Tradicionalisht përcaktohet vepër penale “Çdo veprim njerëzor të cilit ligji i bashkalidh një sanksion penal”. Ky është një përcaktim i llojit formal të veprës penale sepse kufizohet të tregojë fakte që përbëjnë vepër penale për një rregullim pozitiv të përcaktuar. Në formimin e këtij pohimi përkufizimi i sipër përmendur ndikon jo vetëm në natyrën e veprimeve të marra si objekt i disiplinës por dhe mbi mënyrën me të cilën rregullimi juridik reagon kundrejt aktorëve të këtyre fakteve. E shprehur ndryshe koncepti i veprës penale është përcaktuar vetëm në funksion të pasojave juridike (dënimet apo masat e sigurisë) që legjislatori i bashkalidh veprimeve në fjalë.

Përcaktimi i veprës penale dhe parimeve kushtetuese në lidhje me lëndën penale:

Kundërligjshmëria penale paraqet disa karakteristika :

1. **është një krijim legjislativ:** sepse sipas nenit 27 të Kushtetutës¹ vetëm një ligj në kuptimin e ngushtë mund të përcaktojë elementët përbërës; burimet e nivelit të dytë vetëm mund të kontribuojnë për specifikimin e elementëve të përcaktuara ligjërisht në bërthamën thelbësore.
2. **është formulim taksativ:** sepse ligji duhet të përcaktojë me rigorozitetin më të madh të mundshëm veprimet që përbëjnë vepër penale.
3. **ka karakter personal:** ky karakter nënkuptohet jo vetëm në sensin që është e ndaluar çdo formë e “përgjegjësisë për veprimet e tjetrit” por dhe në kuptimin që vepra penale të ketë dhe elementin e fajit.

Kundërligjshmëria penale dhe civile:

Përkufizimi i veprës penale, është i mjaftueshëm për të dalluar kundërligjshmërinë penale nga ajo civile. Në fushën civile nuk dominon parimi i rezervës ligjore me pasojën që një burim normativ i një grade më të ulët të krijojë një figurë kundërligjshmërie, si edhe nuk mbizotëron parimi taksativ, në të kundërt e drejta civile është një terren i privilegjuar i të ashtuquajturit legjislacioni i parimeve dhe përdorimit të klauzolave të përgjithshme. Gjithashtu në rregullimin juridik janë pranuar forma të përgjegjësisë indirekte dhe pa elementin e fajit.

Kundërligjshmëria penale dhe administrative:

Lidhje më të ngushtë ka kundërligjshmëria penale me atë administrative, duke i shtuar kësaj së fundit disa elementë siç janë rezerva ligjore, faji etj. Por të dyja kanë edhe dallime si në gjykim (organi që vendos) por edhe në dënimet përkatëse.

¹ Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tiranë 2005, 15

PËRCAKTIMI SUBSTANCIAL I VEPRËS PENALE

Doktrina penale jo vetëm që ka përcaktuar se çfarë është vepër penale në raport me një rregullim pozitiv por dhe për të nxjerrë në pah arsyet substanciale që cojnë një sjellje të caktuar të emërtohet “kriminale”.

Konceptimet tradicionale:

Në tentativat e ndërmarra në këtë aspekt vlen të theksohet që ka qenë i paevitueshëm interferimi ndërmjet këndvështrimeve të ndryshme; psh. Në një kërkim të tipit shkencor të arsyeve dhe kriterëve të procesit të kriminalizimit të sjelljes njerëzore, shpesh i është mbivendosur një skemë konceptuale që rrjedh jo vetëm nga konceptimet e Shtetit dhe të shoqërisë që shpesh herë dominojnë por edhe nga vetë këndvështrime personale të studiuesve mbi atë që është e preferueshme që Shteti të marrë përsipër objektin e veprës penale.

Përkufizimi substancial i veprës penale, qëllimeve të mbrojtjes të drejtës penale dhe kriteret kushtetuese të politikës kriminale

Veprimet që meritojnë të kualifikohen si vepra penale marin shembuj të vlerave shoqërore të orientuara sipas Kushtetutës. Në të vërtetë përjasja në sistemin kushtetues mund të jetë shumë i frytshëm në pjesën më të madhe të rasteve nga një anë drejt një perceptimi teologjik të kundërligjshmërisë penale dhe nga ana tjetër drejtuar rindërtimit të qëllimeve të sistemit penal sipas Kushtetutës.

Në individualizimin e qëllimeve të mbrojtjes së sistemit penal një fitim i parë duket i qartë:

Vepra penale përkufizohet si një cënim ose vënie në rrezik të një të mire juridike dhe në mënyrë më të saktë të një të mire juridike që shfaqet e denjë për mbrojtjen penale në bazë të direktivave të mbrojtjes që konkludohet nga Kushtetuta. Ekzistenca e kësaj të mire e nevojshme për tu mbrojtur është një supozim i nevojshëm dhe jo i mjaftueshëm për të shkuar në një dënim. Duhet gjithashtu të mbahet parasysh në kuptimin substancial të veprës penale dhe kriteret të tjera që sic e dimë ndikojnë bindshëm në procesin e kriminalizimit të sjelljeve njerëzore: sic janë parimet e subsidiaritetit dhe denjësisë së veprës penale.

Duke u bazuar në këto mendime mund të propozohet përcaktimi substancial që vijon i veprës penale: *Është vepër penale veprimi njerëzor që cënon një të mirë juridike që konsiderohet e denjë për tu mbrojtur nga një legjislator i cili vepron në kuadrin e vlerave kushtetuese, gjithmonë nëse masa e cënimit të jetë e tillë që të bëjë të pamundur shfaqjen e dënimit, dhe sanksionet e tipit jo penal të mos jenë të mjaftueshme në garantimin e mbrojtjes efikase.*

KRIMET DHE KUNDËRVAJTJET

Kundërligjshmëria penale ndahet në krime dhe kundravajtje sipas nenit 1 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë:

Ligji penal dhe ndarja e veprave penale²:

Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre.

Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në cdo rast në dispozitat e pjesës së posacme të këtij Kodi.

² I.ELEZI, S.KACUPI, M.HAXHIA, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2004, 11.

Parimisht krimet duhet të paraqesin format më të rënda të kundërligjshmërisë penale; kundërvajtjet nga ana tjetër paraqesin format më pak të rënda. Historikisht pjesa më e madhe e kundërvajtjeve përbëjnë rezultatin e heqjes dorë në të drejtën penale.

Kritere substancialë dallues

Doktrina juridike është përpjekur prej shumë kohësh në gjetjen e një dallimi substancial ndërmjet krimeve dhe kundërvajtjeve, kërkim që ka arritur në përfundimin që për çdo rast do të bëhet e mundur ndarja e ndërmjet koncepteve politiko-kriminale që dominojnë rast pas rasti.

Sipas një këndvështrimi të bërë nga Beccaria, ndërkohë që krimet dhunojnë sigurinë publike dhe private, që përputhet me integritetin e të drejtave natyrore, kundërvajtjet do të cënonin vetëm ligjet e destinuara për të promovuar një të mirë publike (*mala quia prohibita*)³.

Është shumë e thjeshtë të kundërshtohet që një impostim i tillë jusnaturalistik është larg realitetit të rregullimeve juridiko-penale moderne, të karakterizuara nga një shtim sensibil të krimeve, të vendosur për të mbrojtur interesat e pastra të krijimit legjislativ dhe anasjelltas të kundërvajtjeve, në mbrojtje të të mirave paraekzistuese. Sipas një teorie në të drejtën penale italiane, krimet dhunojnë kushtet parësore, esenziale dhe të përhershme të jetës civile, ndërsa kundërvajtjet kërcënojnë kushtet dytësore dhe kontigjentet e bashkëjetesës⁴.

Si rrjedhim i manifestimit i pavendosshmërisë të kriterit të paraqitur, është për t'u kundërshtuar që edhe kundërvajtjet mund të cënojnë kushtet parësore të jetës sociale: dallimi me krimet mund të konceptohet në inferioritetin e gradës së ofendimit prodhuar nga kundërvajtjet në kushtet parësore të bashkëjetesës.

Është edhe një konceptim tjetër i Arturo Rocco, sipas të cilit, kundërvajtjet janë *''veprime ose mosveprime të kundërta me interesin administrativ të Shtetit''*, interes i cili reflektohet si në aktivitetin e sigurisë policore, si në aktivitetin shoqëror administrativ i cili synon në përmirësimin e kushteve të jetesës civile⁵.

Gjithsesi asnjë nga këto kritere nuk ka arritur të bëjë një ndarje të saktë midis krimeve dhe kundërvajtjeve, kjo sepse roli ndërhyrës dhe inspirues solidar i Shtetit është rritur paralelisht me zhvillimin e këtyre formave të kundërligjshmërisë penale dhe hipotezave kriminale.

Janë bërë shumë diskutime për të arritur në përcaktimin e dallimeve substanciale midis kundërvajtjeve dhe krimeve dhe është arritur në një përfundim skeptik në lidhje me këtë çështje nga doktrina tradicionale e cila ka përcaktuar se ndryshimi midis këtyre dy veprave penale bazohet në kriterin sasior, pra këto dy vepra penale ndahen vetëm sipas gradës së cënimit të së drejtës.

Problematika e kriterëve substanciale për dallimin midis krimeve dhe kundërvajtjeve kohët e fundit ka pasur lidhje dhe me kundërvajtjen administrative. Kjo sepse në këtë mënyrë është tejkaluar kjo ndarje e dyfishtë (ndarja midis kundërvajtjeve dhe krimeve) duke transferuar në bllok të gjithë sektorin të kundërligjshmërisë të kundërvajtjeve në fushën e kundërligjshmërisë që dënohet me sanksionin e gjobës administrative dhe një zgjidhje e tillë politiko kriminale mund të jetë e mundshme duke konsideruar që kundërvajtjet janë klasifikuar tradicionalisht si figura në gradë më të ulët të kundërligjshmërisë dhe në çdo rast më pak të rënda sesa veprimet që përbëjnë krim. Gjithsesi nuk është e këshillueshme që të gjitha kundërvajtjet të transformohen në

³ BECCARIA, Dei delitti e delle pene, Venezia, 1781, VIII e XI; CARMIGNANI, Teoria delle leggi della sicurezza sociale, III, Pisa, 1832, 261 ss.

⁴ IMPALLOMENI, Istituzioni di diritto penale, Torino, 1908, 84 ss; ZERBOGLIO, La teoria e la pratica delle contravvenzioni, Milano, 1899, 20.

⁵ ROCCO Art., L'oggetto del reato e della tutela giuridica penale, in Opere Giuridiche, Roma, 1932, 331 ss.

kundërligjshmërinë administrative sepse ekzistojnë lloje të kundërligjshmërisë të vendosur në një zonë të ndërmjetme të cilët dhe pse nuk kanë të integruara kushtet e kërkuara të kualifikimit në termat e krimit nuk tolerojnë një reduktim të kundërligjshëm administrativ për dy arsye: ose sepse sanksioni i thjeshtë administrativ nuk do të jetë në proporcion me rangun e të mirës së mbrojtur ose gradës së cënimit; ose sepse ky sanksion do të garantonte një parandalim efikas më të vogël në lidhje me sanksionin penal (në këtë kuptim dalin sërish në pah parimet e proporcionalitetit dhe të subsidiaritetit).

Kriteri formal i dallimeve:

Në planin e së drejtës pozitive në fuqi, kriteri më i sigurtë për dallimin midis kundërvajtjeve dhe krimeve mbetet ai i natyrës formale, por duke u bazuar në sanksionet respektive të ndryshme që zbatohen për secilën vepër penale.

Sipas nenit 29 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë⁶:

Për personat që kanë kryer krime jepen këto dënime kryesore:

1. Me burgim të përjetshëm
2. Me burgim
3. Me gjobë

Për personat që kanë kryer kundërvajtje penale jepen këto dënime kryesore:

1. Me burgim
2. Me gjobë

Dallimi midis krimeve dhe kundërvajtjeve merr rëndësi në raport me institute të ndryshme dhe ka një rëndësi shumë të madhe në lidhje me elementin subjektiv të veprës penale dhe të tentativës. Në raste të vecanta legjislacioni jonë lejon plotësisht mundësinë e dhënies së dënimit për tentativë si dhe për veprën penale të kryer.

Megjithatë barazimi i dënimit të tentativës me veprën penale të kryer është një fenomen relativisht i rrallë, sepse në shumë raste kjo bie në kundërshtim me parimin e individualizimit të dënimit në përputhje me rëndësinë e veprës penale të kryer dhe shkallën e rrezikshmërisë së fajtorit, që nuk përputhet me detyrën e përgjithshme të parandalimit të veprave penale⁷.

Dallimi midis krimeve dhe kundërvajtjeve penale ka rëndësi në raportin midis profesionalitetit dhe shpeshhtësisë së veprës penale, masave të sigurisë etj.

Pergatiten:

Av. Arben ISAKU

Lulieta ISAKU (Penaliste)

⁶ Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tiranë 2004, 25.

⁷ I.ELEZI, S.KACUPI, M.HAXHIA, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2004, 167.